

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.
3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.
4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

Constitutional Paragraph: Neni 33 para 1

Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Neni 15 para 1

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk kanë qenë vepra penale sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare në kohën kur janë kryer. Po ashtu nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale. Në qoftë se më vonë, pas kryerjes së veprës, ligji parashikon një dënim më të lehtë, keqburësi duhet të përfitojë nga kjo

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Neni 7 para 1

Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Neni 11 para 2

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose lëshime të cilat, në kohën kur janë kryer ato, nuk përbënin një veprë penale sipas ligjeve kombëtare a ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale.

Ligjet

Nenet

Neni 5

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Kufizimet në ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave të trajtimit të detyrueshëm Me ekzekutimin e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm, kryesit të veprës penale mund ti kufizohen të drejtat e caktuara vetëm deri në atë masë e cila i përgjigjet natyrës apo përmbajtjes së sanksionit ose masës dhe vetëm në mënyrën me të cilën sigurohet respektimi i dinjitetit njerëzor të tij apo saj, në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 2

1. Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

2. Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një veprë nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si veprë penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë veprë.

3. Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale

Ligjet

Nenet

Neni 21

4. Në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas këtij ligji, i akuzuari gëzon të drejtën e garancive minimale të mëposhtme, me barazi të plotë që:

a. të njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij,

b. të informohet me kohë për të drejtat e tij sipas ligjit,

c. të ketë kohën dhe kushtet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe të komunikojë me Mbrojtësin e Specializuar të zgjedhur prej tij,

d. të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme, e. të gjykohet me praninë e tij, dhe të mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë; dhe t'i caktohet Mbrojtës i Specializuar, në çdo rast kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë, dhe pa pagesë në rast se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar,

f. t'i merr në pyetje, ose t'i ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve kundër tij,

g. të ketë ndihmën falas të përkthyesit, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në Dhomën e Specializuar dhe

h. të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes apo të pranojë fajësinë

LIGJI NR. 05/L-053 PËR
DHOMAT E SPECIALIZUARA
DHE ZYRËN E PROKURORIT
TË SPECIALIZUAR
LIGJI NR. 05/L-053 PËR
DHOMAT E SPECIALIZUARA
DHE ZYRËN E PROKURORIT
TË SPECIALIZUAR

decisionTitle*

decisionDescription*

Varvara k. Italisë

Zbatimi i një “mase dënimi” pa një “gjetje fajësie” mund t'i përkasë gjithësesi nenit 7 të Konventës dhe të përbëjë shkelje të kësaj dispozite, meqenëse ndëshkimi i një të akuzuari procesi i të cilit nuk ka përfunduar me një dënim nuk mund të pajtohet me parimin e ligjshmërisë, të garantuar nga ky nen . Logjika e “masës së dënimit” dhe e “ndëshkimit”, si edhe nocioni “guilty” (në versionin anglisht) e nocioni përkatës “person fajtor”, flasin në favor të një interpretimi të tillë të nenit 7 që, për të ndëshkuar, kërkon një deklaram përgjegjësie prej juridiksioneve kombëtare, i cili mund të lejojë që vepra penale t'i vihet në ngarkim dhe masa e dënimit t'i jepet autorit të saj.

Scoppola k. Italisë

Gjykata ka saktësuar se rregullat rreth fuqisë prapavepruese që përmban neni 7 i Konventës zbatohen vetëm për ato dispozita të cilat i përkufizojnë veprat penale dhe masat e dënimit që i ndëshkojnë ato. Në parim, ato nuk zbatohen për ligjet procedurale, zbatimi i menjëhershëm i të cilave në përputhje me parimin tempus regit actum është gjykuar si i arsyeshëm nga Gjykata.

decisionTitle*

decisionDescription*

Streletz, Kessler e
Krenz k.
Gjermanisë

Kur një dënim bazohet vetëm tek e drejta ndërkombëtare ose kur ai u referohet parimeve të së drejtës ndërkombëtare, Gjykata e shqyrton parashikueshmërinë e dënimit në dritën e rregullave të së drejtës ndërkombëtare që kanë qenë të zbatueshme në kohën përkatëse, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare të konventave Streletz, Kessler e Krenz k. Gjermanisë [DhM], §§ 90-10